

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.16/2018 “PËR DIASPORËN”, I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr.81, datë 09.02.2022, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për Diasporën, përgjegjësi kjo që më parë i perkiste Ministrit të Shtetit për Diasporën.

Nëpërmjet miratimit të këtij projektligji synohet forcimi i mëtejshëm i politikave shtetërore për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, duke rritur nivelin e autoritetit shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën nga niveli i një ministri shteti, në nivel Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe nga niveli i një agjencie kombëtare në nivel Ministrie për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në këto kushte, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i lind detyrimi për të bërë një analizë të kuadrit ligjor në fuqi, për çështjet e diasporës, duke mbajtur në konsideratë politikën shtetërore dhe objektivat e MEPJ për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shtetasve shqiptarë, që jetojnë jashtë kufijve të RSH-së.

Në përfundim të kësaj analize, u vlerësua rishikimi i ligjit nr.16/2018 “Për diasporën” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe shfuqizimi i ligjit nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Ky projektligj synon të përshtasë përmbajtjen e ligjit nr.16/2018 me ndryshimet që sjell ndryshimi i statusit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës (AKD) nga institucion i pavarur, si dhe të bëjë disa ndryshime në

formë dhe përmbajte të ligjit ekzistues, me qëllim qartësimin e dispozitave të tij, veçanërisht të përgjegjësive, funksionimit dhe organizmit të veprimtarisë së strukturave përkatëse të krijuara në këtë ligj.

Të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, shfuqizuar me ligjin nr.7/2024, tashme rregullohen nëpërmjet krijimit të AKD-së si institucion varësie për të kryer funksione administrative të përcaktuara brenda fushës së përgjegjësisë së MEPJ-së, në kuptim të nenit 6 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Diaspora edhe pse *de facto* ka qenë gjithnjë në fokus të veprimtarisë së shërbimit të jashtëm, tashmë me VKM nr. 82/2022, ka kaluar edhe *de jure* në fushën e përgjegjësisë së MEPJ-së.

Këto ndryshime synojnë përmirësimin e ligjit për diasporën, rritjen e ndërveprimit me komunitetin shqiptar jashtë Shqipërisë, përcaktimin e procedurave dhe mekanizmave për rritjen e bashkëpunimit me diasporën, me qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar.

Projektligji për ndryshimin e ligjit 16/2018 “Për diasporën” i ndryshuar është dërguar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, nëpërmjet vendimit nr.161, datë 24.03.2023, por me qëllim përmirësimin dhe pasurimin e draftit të dërguar, si dhe adresimin e sugjerimeve konkrete nga diaspora gjatë Samitit të III-të Diasporës, të mbajtur në Tiranë, në datat 22-23 nëntor 2023, projektligji i depozituar në Kuvend është tërhequr nga Këshilli i Ministrave, me propozim të MEPJ-së, për ripunim.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi i këtij projektligji nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të propozohen për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2024 nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, por është hartuar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga programi i qeverisë shqiptare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me kalimin e çështjeve të diasporës në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me VKM-në nr.81, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, ka lindur nevoja që Agjencia Kombëtare e Diasporës të vendoset nën varësinë e MEPJ, jo vetëm në kryerjen e funksioneve të saj të cilat kërkojnë shkallë të lartë specializimi, por edhe në zbatim të objektivave të kësaj ministrie në politikën e saj ndaj diasporës.

Për rrjedhojë, ndryshimin i ligjit aktual për diasporën dhe shfuqizimi i ligjit për Agjencinë Kombëtare për Diasporën, passjell domosdoshmërinë për përmirësimin dhe harmonizimin e ligjit për diasporën me ligjin nr. 23/2015 “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim garantimin e zbatimit të politikave shtetërore për ndjekjen e çështjeve lidhur me diasporën dhe organizimin e strukturave përgjegjëse.

Gjithashtu, ndryshimet synojnë të shmangin mospërputhjen e kuadrit rregullator për diasporën, si pasojë e ndryshimeve të menjëhershme që sjell shfuqizimi i ligjit nr.115/2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

MEPJ bën hartimin e politikave shtetërore për diasporën, ndërmerr hapa të rëndësishëm dhe konkret për ruajtjen e lidhjeve të diasporës me vendin e origjinës, tërheqjen dhe rritjen e kontributeve të diasporës në atdhe, jo vetëm në aspektin ekonomik por edhe të burimeve dhe resurseve njerëzore, duke u bazuar edhe në planet e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën për vitet 2021-2025.

Institucionalizimi i “*diplomacisë së diasporës*” është një tendencë edhe e vendeve të tjera me diasporë të konsiderueshme, dhe përpjekja për ta përfshirë diasporën në MEPJ, dëshmon rëndësinë që duhet t’i jepet centralizimit të çështjeve të diasporës nën një ombrellë të vetme, përpjekje e cila do të krijojë lehtësi në qasjen koherente të politikave të angazhimit ndaj diasporës, në mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të

Diasporës, si dhe do të mundësojë një kanal të vetëm komunikimi, në vend të atij me shumë drejtime, që kemi pasur deri më tani.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrim me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2081, “Për Diasporën”, i ndryshuar, të cilat do të ndikojnë edhe aktet nënligjore të propozuara në bazë dhe për zbatim të ligjit nr.16/2018.

Në projektligjin që paraqitet për shqyrtim janë bërë riformulime paragrafesh me qëllim përmirësimin e tekstit (aty ku ka detaje që përsëriten apo që nuk përmirësojnë normën) dhe adresimin e sugjerimeve konkrete nga diaspora gjatë Samitit të III-të Diasporës, konkretisht:

1. Nëpërmjet **Nenit 1** të projektligjit, janë bërë disa ndryshime në nenin 1 të ligjit nr.16/2018 (Objekti), me qëllim pasqyrimin sa më të mirë të objektit të ligjit.
2. Nëpërmjet **Nenit 2** të projektligjit, janë bërë disa ndryshime në nenin 2 të ligjit nr.16/2018 (Përkufizime), ku pika 3 e këtij neni (Ministri përgjegjës), bëhet pika 1 e tij dhe pika 1 ku përkufizohet AKD, shfuqizohet, pas kalimit të saj në varësinë e MEPJ-së.
3. Nëpërmjet **Nenit 3** dhe **Nenit 4** të projektligjit, janë bërë disa ndryshime në Kreun II dhe nenin 3 të ligjit nr.16/2018 (Organet shtetërore përgjegjëse për diasporën), ku titulli ndryshohet në

“Organet përgjegjëse për Diasporën”, pasi është më gjithëpërfshirës, duke qenë se në këtë nen përfshihet edhe Këshilli Koordinues për Diasporën (KKD), i cili nuk është organ shtetëror.

Hiqet nga lista e institucioneve përgjegjëse për diasporën “Komiteti Shtetëror për Diasporën”, i cili përmblihte disa institucione në vendimmarrje, ndërkohë që jemi në situatën kur vendimmarrja i takon MEPJ-së, si edhe “Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, i cili ka pushuar së funksionuari dhe ligji që e parashikon është në proces propozimi për shfuqizim.

4. Nëpërmjet **Nenit 5** të projektligjit, shfuqizohet neni 4/1 i ligjit nr.16/2018 (Komiteti Shtetëror për Diasporën), i cili ekzistonte në kohën e një Ministri Shteti për Diasporën dhe ku vendimet për çështje të ndryshme të diasporës merreshin nga ky komitet që përfshinte disa institucione. Në realitetin aktual, kur AKD është pjesë integrale e MEPJ-së, vendimet nuk mund të merren nga institucione të tjera, por vetëm nga MEPJ. Si rrjedhim, ky komitet pushon së funksionuari.
5. Nëpërmjet **Nenit 6** të projektligjit, hiqet pika “e”, në Nenin 5 të ligjit nr.16/2018 (Ministri përgjegjës për diasporën), pasi është i panevojshëm të përfshihet përkrahimi i punës në përmbajtjen e këtij neni.
6. Nëpërmjet **Nenit 7** të projektligjit, bëhen disa ndryshime në nenin 6 të ligjit nr.16/2018 (Qendrat kulturore për diasporën), ku ndryshohen pikat 3, 4 dhe 7 të këtij neni, si më poshtë:

“3. Kreu i QKD-së emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe është në varësi të Kreut të Misionit Diplomatik. Gjatë kohës së shërbimit në misionin diplomatik, Kreu i QKD-së gëzon statusin e diplomatit.

4. QKD-ja ushtron funksionet në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe detyrime të tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e QKD-së rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës.

7. Struktura dhe organika e QKD-së miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme”.

Pra, këto qendra do të krijohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, pasi të jetë marrë miratimi i shtetit ku do të hapen qendrat, dhe do të jenë në varësi të Kreut të Misionit diplomatik të akredituar në shtetin ku do të hapet qendra. Ndër të tjera me ndryshimet e paraqitura në këtë nen, synohet të rregullohet çështja e statusit të Kreut të QKD-së, duke përfshirë këtu rregullimin edhe për rastet kur Kreu i QKD-së, vjen nga diaspora, pra është shtetas i shtetit ku është e hapur QKD-ja, dhe si i tillë nuk do të ketë të njëjtin trajtim në privilegje dhe imunitete si diplomati.

Gjithashtu pikat 5 dhe 6 të këtij neni shfuqizohen, si pasojë e këtyre ndryshimeve.

7. Nëpërmjet **Nenit 8** të projektligjit, shfuqizohet shkronja “ç” e nenit 7 të ligjit nr.16/2018 (Përgjegjësitë e QKD-së), pasi në ligjin aktual kishte përsëritje në përmbajtje me paragrafët “a”, “b”, “c”.
8. Nëpërmjet **Nenit 9** të projektligjit, bëhen disa ndryshime në pikat 1, 2, 5 dhe 6 të nenit 10 të ligjit nr.16/2018 (Përkrahja për mësimin dhe avancimin e gjuhës shqipe), ku shtohet në përmbajtjen e tij edhe gjuha arbëreshe. Arbërishtja është gjuha e ngulimeve shqiptare në Itali, e cila lidhet kohësisht me periudhën prej shekullit XV deri në shek. XVIII kur shqiptarët emigruan drejt Italisë. Gjithashtu në këtë nen bëhen edhe ndryshime të teknikës legislative.
9. Nëpërmjet **Neneve 10 dhe 11** të projektligjit, bëhen disa ndryshime të vogla të teknikës legislative, në nenin 11 (Bashkëpunimi kulturor dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë) dhe nenin 12 (Bashkëpunimi në fushën e sportit).
10. Nëpërmjet **Nenit 12** të projektligjit, ndryshohet neni 13 i ligjit nr.16/2018 (Informimi), ku hiqet fjalia e dytë e pikës 1 të këtij neni, pasi nuk mund të përfshihen në ligj efektet financiare të një institucioni shtetëror, si edhe bëhen disa rregullime të teknikës legislative.

11. Nëpërmjet **Nenit 13** të projektligjit, riformulohet titulli i nenit 14 të ligjit nr.16/2018 (Ekonomia dhe shkenca), si “Bashkëpunimi ekonomik dhe shkencor”, duke pasqyruar më qartë përmbajtjen e këtij neni.
12. Nëpërmjet **Nenit 14** të projektligjit, bëhet një ndryshim në nenin 15 të ligjit nr.16/2018, ku në pikën 1 të këtij neni, hiqet termi “Ambasador i Kombit”, pasi ky titull me kalimin e kohës mund të ndryshojë, ndaj titulli duhet të mbetet i pa specifikuar.
13. Nëpërmjet **Nenit 15** të projektligjit, bëhen disa ndryshime në nenin 18 të ligjit nr.16/2018 (Këshilli Koordinues i Diasporës), ku janë qartësuar funksionet e Këshillit Koordinativ të Diasporës (Këshilli), si organ koordinues dhe shtohen disa paragrafë mbi kompetencat e Këshillit, si më poshtë:
 - “c) Bashkëpunon me organet përkatëse për organizimin e Samitit të Diasporës.
 - ç) Këshilli Koordinues i Diasporës identifikon, trajton, dhe propozon çështje dhe projekte me natyrë ekonomike, ligjore, kulturore, shkencore e sportive për diasporën”.

Shfuqizohet pika 4 e këtij neni, si pasojë e ristrukturimit të AKD.

14. Nëpërmjet **Nenit 16** të projektligjit, bëhen disa ndryshime në nenin 19 të ligjit nr.16/2018 (Përbërja e Këshillit), ku është rritur numri i anëtarëve të KKD-së, në mënyrë që të kemi një përfaqësimin sa më mirë në Këshill, duke parashikuar jo më pak se 21 anëtarë në Këshill nga 15 anëtarë që parashikon ligji aktual.
15. Nëpërmjet **Nenit 17** të projektligjit, ndryshohet neni 20 i ligjit nr.16/2018 (Kriteret për zgjedhjen në Këshill), pasi në përbërjen e Këshillit ka vende të përcaktuara specifikisht. Duke marrë në konsideratë që diaspora është e lëvizshme gjeografikisht dhe numri i shqiptarëve jashtë ndryshon gjatë kohës nga një shtet në tjetrin, nuk mund të citojmë specifikisht vendet nga zgjidhen anëtarët e KKD-së, ndërkohë që mund të lihen jashtë shumë vende apo dhe kontinente ku shqiptarët janë të pa përfaqësuar. Ndaj ky nen duhet të jetë më gjithëpërfshirës. Si rrjedhojë, janë hequr shtetet specifike nga ku

zgjidhen anëtarët në Këshill, si edhe është hequr pika 4 e këtij neni, sepse përzgjedhja përfundimtare e anëtarëve të KKD-së bëhet nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme.

16. Nëpërmjet **Nenit 18** të projektligjit, shfuqizohet neni 22 i ligjit nr.16/2018, (Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës), pasi ky fond ka humbur funksionin e tij, si organ që ka pasur për qëllim sigurimin e mjeteve financiare në mbështetje të zhvillimit të diasporës, pasi ligji që e parashikon është në proces shfuqizimi.
17. Nëpërmjet **Nenit 19** të projektligjit, është shtuar një nen ri në ligjin nr.16/2018, neni 22 (Agjencia Kombëtare e Diasporës), ku parashikohet Agjencia Kombëtare të Diasporës, tashmë si një institucion në varësi të ministrit përgjegjës për diasporën, si institucioni zbatues për “diplomacinë e diasporës”, si dhe rregullimi ligjor për krijimin, organizimin dhe funksionimin e AKD-së, si institucion varësie.
18. Nëpërmjet **Nenit 20** të projektligjit, në pikën 1, të nenit 23 të ligjit nr.16/2018 (Qendra e Botimeve për Diasporën), togfjalëshi “Ministrit përgjegjës për diasporën”, ndryshohet në “Ministrit përgjegjës për arsimin”, pasi QBD-ja është institucion në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin.
19. Nëpërmjet **Nenit 21** të projektligjit, shfuqizohet neni 26 i ligjit nr.16/2018, pasi logot e organeve publike miratohen me VKM.
20. Në **Nenin 22** të projektligjit, përcaktohet nxjerrja e aktit nënligjor nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 22 (AKD) të ligjit nr.16/2018.
21. Në **Nenin 23** të projektligjit, përcaktohet hyrja në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe institucionet në varësi të saj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.16/2018 “Për diasporën”, i ndryshuar” është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur me urdhrin e MEPJ-së nr.537, datë 29.12.2023, për këtë qëllim. Janë zhvilluar tre takime në ambientet e MEPJ-së, të kryesuara nga Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, që mbulon çështjet e diasporës, me përfaqësues nga MEPJ dhe institucionet si më poshtë:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD);
- Qendra e Botimeve për Diasporën (QBD);
- Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA);
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM Albania);
- Dhoma e Biznesit për Diasporën (DHBD).

Në takimet e Grupit të Punës kanë marrë pjesë online edhe përfaqësues nga Këshilli Koordinativ për Diasporën (KKD), të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në projektligj.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektakti nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.